



Pranuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received / Delivered	12-01-2023	3	viti (god year)
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	SKINYSALC	243/2023	Sasia Kolicina Quantity
			115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 846/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.846/2018, të datës 24.12.2018, të ankuesit

sipas Aktgjykimit A.nr. 2615/2021 të datës 29.11.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me adresë banimi rruga "Haxhi Sylja", Komuna e Drenasit, kundër organit të punësimit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.01.2023, mori këtë

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.846/2018, e datës 24.12.2018, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi, vendimi me numër protokolli 3200, i datës 07.09.2018, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

A r s y e t i m

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datë 07.09.2018, me numër protokolli 3200, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndërprerje e marrëdhënies se punës në Shërbimin Civil“, me arsyetimin se Gjykata Themelore në Prishtinë e ka shpallur fajtor dhe është dënuar për veprë penale, me Aktgjykim PKR.nr.24/17 të datës 08.05.2018 dhe të plotfuqishëm nga data 08.06.2018, të Departamentit për Krime të Rënda/Gjykata Themelore në Prishtinë i cili aktgjykim ka marr formë të prerë.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 07.09.2018, me numër protokolli 3200, të Komisionit Disiplinor, me datën 08.10.2018, me numër protokolli 137, me ankesë i është drejtuar

Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Po ashtu ankuesi me datën 10.12.2018, me numër protokolli 514, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ndërsa ankuesi, i pakënaqur me mos marrjen e përgjigjes së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 24.12.2018, ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore për kthim në vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 23.01.2019, me numër protokolli 395/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa me datën 28.01.2019 me numër protokolli 494/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.09.2019, me numër protokolli 4031/2019, ka njoftuar ankuesin se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A.nr. 846/2018, të datës 24.12.2018, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 13.09.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr. 438/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 07.06.2019, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.846/2018, të datës 24.12.2018 .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.10.2021, me numër protokolli 5017/2021, ka njoftuar ankuesin, se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A.nr. 846/2018, të datës 24.12.2018, për shkak se Këshilli nuk ka kuorum për vendimmarrje, duke e udhëzuar të njëjtin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, i pakënaqur me njoftimin e datës 14.10.2021 ,të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 29.11.2022, ka nxjerr Aktgjykimin A.nr. 2615/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 14.10.2021, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.808/2021, të datës 16.09.2021 të ankuesit

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave me rastin e vendosjes meritore në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.846/2018, e datës 24.12.2018, me numër protokolli 7907/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 03.09.2019 dhe 14.10.2021 i Këshillit për pamundësinë e vendimmarrjes në lidhje me ankesën ;Aktgjykimi A.nr.438/2019, i datës 13.09.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi A.nr. 2615/2021, i datës 29.11.2022, i Gjykatës Themelore në**

Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Ankesa e datës 10.12.2018 me numër protokollit 514 dhe Ankesa e datës 08.10.2018, me numër protokollit 437, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të MPMS-së; vendimi i datës 07.09.2018 me nr.pro.3200 i Komisionit Disiplinor; Aktgjykimi i datës 08.05.2018, i Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda; Vendimi i datës 26.09.2016 për pezullim nga detyra të ankuesit; kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore e datës 19.07.2018; Përgjigje në ankesë e datës 28.01.2019, me numër protokollit 494/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_, është e pa bazuar sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi ka qenë i emëruar për kohë të pacaktuar (përhershme) në pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim-Rajoni i Prishtinës në Inspektorat të Punës" në kuadër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Bazuar në shkresat e administruara të lëndës është konstatuar se Kryeinspektori i Punës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës, si dhe akteve nënligjore bazuar në këto ligje, ankuesin me Vendimin me numër protokollit 977/2016 të datës 26/09/2016 e kishte pezulluar me 50 % të pagës nga marrëdhënia e punës me arsyetimin se ndaj të njëjtit ishte iniciuar procedurë penale nën dyshimin e kryerjes se veprës penale "Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar" dhe se i njëjti mbahet në arrest.

Me datë 07.09.2018, organi përkatës i punësimit përkatësisht komisioni disiplinor i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 3200 lidhur me Ndërprerjen e marrëdhënies se punës për ankuesin me arsyetimin se ankuesi sipas Aktgjykimit PKR. Nr.24/17 të datës 08.05.2018 (*i plotfuqishëm më datë 08/06/2018*) të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me Gjobë në shumë prej 2000(dymijë)euro dhe me dënim me burg prej 180 ditë - gjashtë muaj duke e llogaritur qëndrimin në paraburgim nga data 23.09.2016, deri me datën 11.10.2016 (17 ditë), i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej tremijedyqindegjashtëdhjet(3260) euro.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës dhe duke analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenin 90 të këtij ligji, konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit për shkelje të ligjit material, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike janë të pa bazuara sepse nga analizimi i Aktgjykimit PKR. Nr.24/17 të datës 08.05.2018 (*i plotfuqishëm më datë 08/06/2018*) të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, rrjedh se ankuesi është shpallur fajtor për veprë penale "Marrje Ryshfeti" nga neni 428 paragrafi 1 i KP-së, dhe rrjedhimisht i njëjti është dënuar me dënim me Gjobë në shumë prej 2000(dymijë)euro dhe me dënim me burg prej 180 ditë-gjashtë muaj duke e llogaritur qëndrimin në paraburgim nga data 23.09.2016, deri me datën 11.10.2016 (17 ditë), i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej tremijedyqindegjashtëdhjet(3260) euro, kështu që sipas vlerësimit të Kolegjit të Këshillit organi përkatës i punësimit me rastin e nxjerrjes se vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies se punës për ankuesin ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejtë ka zbatuar ligjin material ngase ankuesi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprën penale "Marrje Ryshfeti" dhe se të njëjtit konform dispozitave ligjore përkatësisht nenit 90 të Ligjit Nr.03/L-

149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të drejtë i është shqiptuar masa disiplinore e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil", ka vepruar në pajtim me nenin 63, paragrafi 4 të, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se; "4. Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil", mbi këtë bazë kolegji konstaton se ndërmarrja e veprimeve disiplinore nga organi i punësimit, rrjedhimisht edhe vendimi janë konform dispozitave ligjore që rregullojnë Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, mbi bazë të asaj që u tha më lartë dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi me Aktgjykimin PKR.Nr.24/17 të datës 08.05.2018 (i plotfuqishëm më datë 08/06/2018) të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Renda, ankuesi është shpallur fajtor për vepër penale "Marrje Ryshfeti" nga neni 428 paragrafi 1 i KP-së, dhe rrjedhimisht i njëjti është dënuar me dënim me Gjobë në shumë prej 2000(dymijë)euro dhe me dënim me burg prej 180 ditë - gjashtë muaj duke e llogaritur qëndrimin në paraburgim nga data 23.09.2016, deri me datën 11.10.2016(17 ditë), i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej tremijedyqindegjashtëdhjet(3260) euro, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit material, si dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, janë të pazuar, ndërsa vendimi me numër protokolli 3200, i datës 07.09.2018 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është i drejt dhe i ligjshëm.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.846/2018, datë 12/01/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Arkivit të KPMSHCK-së